REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 1688/1 prot.

Tiranë, më 26.7.2024

# URDHËR

**Nr. 1258, datë 26.7.2024**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË DOKUMENTIN "POLITIKA DHE PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË KANDIDATËVE PËR OFICERË TË RINJ NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", MIRATUAR ME URDHËR TË MINISTRIT TË MBROJTJES NR. 1269, DATË 19.07.2023**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të shkronjës "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; ligjit nr. 37/2024, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

**U R DH Ë R O J:**

1. Në dokumentin "Politika dhe procedura e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 1269, datë 19.07.2023, germa "ç" e nënpikës 2.2, të pikës 2, ndryshon dhe bëhet:

   "ç) Mosha e rekrutimit të kandidatëve/aplikantëve jo më pak se 18 dhe jo më shumë se 24 vjeç e gjashtë muaj në ditën e fillimit të vitit akademik."

2. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Personelit (J-1), Qendra e Personel-Rekrutimit, Akademia e Forcave të Armatosura dhe të gjitha strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

3. Ndjek zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Niko Peleshi**